


Problema me 3 pikë

1. Akili ndezi 5 qirinj të njëjtë në të njëjtën kohë.

Ata ndaluan së djeguri në periudha të ndryshme kohe dhe tani duken siç tregohet në figurë. Cilin qiri shuajti të parin?




- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E

2. Disa monedha kanguri janë mbledhur dhe formojnë vlerën 51 (si në figurë). Dy prej tyre, që kanë shenjën e pikëpyetjes, kanë të njëjtën vlerë. Sa është kjo vlerë?

$$\text{20} + \text{10} + \text{10} + \text{?} + \text{?} + \text{1} = 51$$

- (A) 1 (B) 2 (C) 5 (D) 10 (E) 20


3. Një rreth gri me 2 vrima të mëdha vendoset mbi orë, siç tregohet më poshtë.




Rrethi gri rrotullohet rreth qendrës së tij.

Cilët nga çiftet e numrave mund të shikoni pas rrotullimit?

- (A) 4 dhe 9 (B) 5 dhe 9 (C) 5 dhe 10 (D) 6 dhe 9 (E) 7 dhe 12



4. Liza ka këto formuese:




Për të formuar këtë katror asaj i duhet të bashkojë 2 nga formueset. Cilat janë këto formuese?

- (A) 1 dhe 2 (B) 1 dhe 3 (C) 1 dhe 4 (D) 2 dhe 3 (E) 2 dhe 4


5. Një elektrikist në teatër ndez dhe fik dritat sipas planit të treguar.

Sa është koha e përgjithshme që 2 nga dritat të rrinë ndezuar njëherësh?



- (A) 2 minuta (B) 6 minuta (C) 8 minuta (D) 9 minuta (E) 10 minuta


6. Kastrioti e palosi letrën e tejdukshme sipas vijës së ndërprerë.



Cilën nga figurat shikon ai pas këtij veprimi?

- (A) (B) (C)
 (D) (E)

7. Teuta ka 4 disqe me madhësi të ndryshme. Ajo dëshiron të ndërtojë një kullë me 3 disqe në mënyrë që çdo disk të jetë më i vogël se disku poshtë tij. Sa kulla të ndryshme mund të ndërtojë Teuta?



- (A) 1 (B) 2 (C) 4 (D) 5 (E) 6


8. Dani ngjiti 2 copat e letrës mbi rrethin e zi .
 Cilin nga rastet e mëposhtme nuk mund të marrë ai pas këtij veprimi?

- (A) (B) (C) (D) (E)


Problema me 4 pikë

9. Forma në të djathtë do të mbulohet me 5 copat e mëposhtme. Cila është copa që do të mbulojë pikën e treguar me shigjetë?

- (A) (B) (C) (D) (E)




10. Roza ka gjashtë pesha prej 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 kg. Ajo vendos pesë prej tyre në peshore dhe njëren e lë mënjanë, në mënyrë të tillë që peshorja të qëndrojë në ekuilibër.
 Cilën peshë ka lënë mënjanë ajo?




- (A) 1 kg (B) 2 kg (C) 3 kg (D) 4 kg (E) nuk është e sigurt

11. Aliu ka një vizore 60 cm të gjatë. Fatkeqësisht, disa nga shenjat janë fshirë. Ai është në gjendje të masë gjatësitë 10, 20, 30, 40, 50 dhe 60 cm duke përdorur vizoren e tij vetëm një herë. Cila është vizorja e Aliut?



12. Zona e paraqitur në figurë ka 7 shtëpi që ndodhen në veri të rrugës A, 8 shtëpi në lindje të rrugës B dhe 5 shtëpi në jug të rrugës A. Sa shtëpi janë në perëndim të rrugës B?


- (A) 4 (B) 5
(C) 6 (D) 7
(E) 8



13. Në radhë për të hipur në traget presin 8 makina. Në çdo makinë ndodhen ose 2 ose 3 persona. Në total janë 19 persona që presin tragetin. Sa makina kanë saktësisht 2 persona?

- (A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6

14. Linja e Metros ka 6 stacione, A, B, C, D, E dhe F. Treni ndalon në çdo stacion. Kur arrijn në njërin nga dy stacionet e fundit, ai ndryshon drejtimin.




Makinisti i trenit filloi ta ngjiste trenin në stacionin B dhe ndalesa e tij e parë ishte stacioni C. Cili do të jetë stacioni i 96-të ku makinisti do të ndalojë trenin?


- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E

15. Hana dëshiron të ngjyrosë rrathët e figurës. Ajo dëshiron të ngjyrosë çdo dy rrathë të lidhur me vijë me ngjyra të ndryshme. Sa është numri më i vogël i ngjyrave që do të përdorë ajo?

- (A) 2 (B) 3 (C) 4
(D) 5 (E) 6



16. Shkëndia ecën nëpër labirintin dykatësh nga Hyrja te Dalja, duke kaluar para 3 pikturave të ngjitura në mur. Në cilën radhitje do t'i shohë ajo?




Problema me 5 pikë

17. Në një rresht janë vendosur 6 kastorë dhe 2 kangurë. Ndër çdo 3 kafshë të vendosura radhazi, vetëm 1 është kangur. Në cilin nga numrat e mëposhtëm ndodhet kanguri?



- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5


18. Rezarta palosi dy herë një copë letre katrore (si në figurën më poshtë) sipas vijave të ndërprera. Pastaj ajo pret një cep. Si do të duket letra pasi ajo ta shpalosë?



19. Gazmira, Taulanti dhe Rinori hyjnë gjithmonë në dhomën e përbashkët një nga një. Gazmira nuk është kurrë e para, Taulanti nuk është kurrë i dyti dhe Rinori nuk është kurrë i treti. Në sa mënyra të ndryshme mund të hyjnë ata në dhomë?


- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 6

20. Në mur janë vendosur pesë orë. Dihet që një nga orët është 60 min përpara, një nga orët është 60 min mbrapa, një nga orët tregon kohën e saktë dhe dy prej tyre kanë ndalur. Cila nga orët e mëposhtme tregon kohën e saktë?




- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E


21. Agroni dhe Brikena kanë nga 9 sfera secili. Së bashku, ata kanë 8 sfera të kuqe dhe 10 blu. Brikena ka dy herë më shumë sfera blu se të kuqe. Sa sfera blu ka Agroni?




- (A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 0

22. Etleva ka dy makina. Kur ajo vendos një fletë letre katrore në makinën R, ajo e rrotullon letrën me 90° në drejtim të akrepave të orës, siç tregohet në figurë.

Kur ajo e vendos letrën në makinën S, ajo e vulos letrën me stikun .



Si duhet të vendosen makinat që të arrihet rezultati si në figurën e mëposhtme?




- (A) SRR (B) RSR (C) RSS (D) RRS (E) SRS

23. Mësuesja Shpresa dëshiron të shkruajë brenda çdo rrethi një nga numrat 1 deri në 7. Ajo dëshiron që shuma e numrave në 2 rathë që janë pranë njëri-tjetrit të jetë sa numri që tregohet në brinjën që lidh dy rathët.

Cilin numër duhet të shkruajë ajo brenda rrethit me ngjyrë?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5



24. Maria ka ngjyrosur në tabelën 4×4 vetëm 5 kuti. Ajo sfidon 5 shoqet e saj që të gjejnë se cilat nga kutitë ka ngjyrosur. Tabelat që kanë ngjyrosur shoqet e Maries paraqiten më poshtë. Maria i shikon dhe u thotë: “Njëra prej jush ka të drejtë dhe secila prej jush ka katër kutiza të sakta”. Cila është përgjigja e saktë?

